- e. *Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

3. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas pikës 1 të kësaj shtojce.

3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

3.2.1 *Ne përmbushje të kapacitetit ekonomik dhe financiar, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar xhiro mesatare vjetore, gjatë tre viteve të fundit financiare, në një vlerë të pakten prej 10,000,000 (dhjetë milion) Lekë.*

Operatorët ekonomik që kanë aktivitet me pak se 3 (tre) vite, duhet të kenë xhiro mesatare, në vlerën e kerkuar të pakten prej 10,000,000 (dhjetë milion) Lekë pa TVSH.

Si prova për plotësimin e këtij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore ku të tregohet xhiroja vjetore për vitet e sipërpermendura ose kopje të certifikuar të bilanceve.

3.3 Kapaciteti teknik:

3.3.1 *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, kontrata të ngjashme në një vlerë të pakten prej 10,000,000 (dhjetë milion) lekë.*

Lidhur me këto pike:

Kur OE ka realizuar kontrata me një ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara. *Faturat tatimore duhet të jenë të nenshkruara nga shitesi dhe bleresi.*

- 3.3.2 *Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikatat e leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, qe kane lidhje me objektin e kontrates, si me poshte:*
- *ISO 9001: ose ekuivalente në fushën e cilësisë në të njëjtën fushë me objektin e prokurimit, (të vlefshme).*
- 3.3.3 *Operatori ekonomik ofertues për te bere te mundur kryerjen e këtij sherbimi duhet te provoje se ka ne stafin e tij te pakten 1(nje) inxhiner informatik/elektronik.*
Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues per te gjithë stafin e kerkuar me siper operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:
- i) *listepagesat ku te konfirmohet qe eshte punonjës i operatorit ekonomik te pakten per 6 (gjashte) muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit;*
 - ii) *CV, libreze pune, diplome, certifikata, qe vertetojne se punonjesi i disponon aftesite profesionale te tij ne perputhje me kerkesat e lartpermendura.*
- 3.3.4 *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese autorizimin e prodhuesit ose distributorit te autorizuar per mallrat objekt prokurimi. Autorizimi i prodhuesit ose distributorit te autorizuar duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.*
- 3.3.5 *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese katalogun e prodhuesit per mallrat objekt prokurimi, pjesa qe i perket te dhenave teknike te jete e perkthyer ne gjuhen shqipe.*
- 3.3.6 *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese nje deklarate ku te cilesoje se mallrat e ofruara prej Tij, jane te reja dhe jo te rikonstruara.*
- 3.3.7 *Ne funksion te plotesimit te Shtojces 7 “Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shenim: Në respekt të nenit 23 të LPP – së, në të gjithë rastet ne dokumentet e tenderit kur përmendet “markë” përfshihet termi “ekuivalente”.

Shtojca 9

[Shtojcë për t’u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Zgjerimi dhe rritja e kapaciteteve të transmetimit mbi rrjetin OPGW”

Tabela e Permbajtjes

1. Pershkrimi i projektit
 - 1.1. Qellimi
2. Arkitektura e sistemit
 - 2.1. Te pergjithshme
 - 2.2. Nyja kryesore OTN
 - 2.3. Stacioni terminal
 - 2.4. Stacion amplifikimi
 - 2.5. Stacion switching
 - 2.6. NMS - Sistemi i menaxhimit te rrjetit
 - 2.7. Mundesia e zgjerimit dhe perditesimit
 - 2.8. Testet e pranimit
 - 2.9. Integrimi i Sistemit
 - 2.10. Dokumentacioni
 - 2.11. Garancia, suportit dhe mirëmbajtja
 - 2.12. Pjesët rezerve
 - 2.13. Licensat
 - 2.14. Zgjerim i kapacitetit dhe i sistemit fillestar
3. Përshkrimi i zgjidhjes teknike
 - 3.1. Kerkesat per sistemin e rritjes se kapaciteteve te OPGW
 - 3.2. Kërkesat e arkitektures se sistemit
 - 3.3. Modelimi i Sistemit dhe Projektimi i Rrjetit
 - 3.4. Menaxhimi i fuqise dhe Monitorimi i Fibrave
 - 3.5. Kanali optik i supervizimit
 - 3.6. Faktori “Latency” dhe “Jitter”
 - 3.7. Enkapsulimi i sinjalit te klientit
 - 3.8. Mekanizmi LLF (Link Loss Forwarding)
 - 3.9. Monitorimi i pajisjes
 - 3.10. Monitorimi i performancës
 - 3.11. Mbrojtja
 - 3.12. Hardware
 - 3.12.1. Arkitektura e Hardware-it
 - 3.12.2. Përmirësimet (Upgrade) e kapacitetit
 - 3.12.3. Disponueshmëria
 - 3.12.4. Ripërteritja e hardware-it

- 3.12.5. Ripërteritja e software-it
- 3.12.6. Llojet e ndërfaqeve
- 3.13. Arkitektura WSS (Wavelength Selective Switch) / ROADM (Reconfigurable Optical Add Drop Multiplexer Technology)
 - 3.13.1. Shtresa Optike Grooming
 - 3.13.2. Shkallezimi i nyjes së komutimit optik
 - 3.13.3. Kërkesat e sistemit OTN
 - 3.13.4. Kërkesat për 100G
- 4. Sistemi i Menaxhimit të Rrjetit (NMS- Network Management System)
 - 4.1. Sistemi i Menaxhimit të Rrjetit
 - 4.2. Funksionet e menaxhimit Rrjeti
 - 4.2.1. Funksioni i konfigurimit të rrjetit
 - 4.2.2. Funksioni i menaxhimit të alarmeve
 - 4.2.3. Funksioni i menaxhimit të performancës
 - 4.2.4. Funksioni i Menaxhimit të Sigurisë
 - 4.3. Ndërfaqja e përdoruesit të sistemit të menaxhimit të rrjetit
 - 4.4. Arkitektura e sistemit të menaxhimit të rrjetit
 - 4.4.1. Redundanca dhe qëndrueshmëria e menaxhimit
 - 4.4.2.
- 5. Certifikata dhe referenca për rrjetin
- 6. Aksesore dhe elemente të ndryshëm
- 7. Karakteristikat teknike të Sistemit të menaxhimit të rrjetit (NMS)
- 8. Karakteristikat teknike të pajisjeve terminale të rrjetit
- 9. Karakteristikat teknike të pajisjeve switch ethernet të rrjetit
- 10. Tabela - Rritja e kapaciteteve të transmetimit të OPGW

1. Përshkrimi i projektit

1.1. Qëllimi

Sistemi i transmetimit të energjisë elektrike të Shqipërisë është një sistem i rëndësishëm që garanton furnizimin me energji elektrike të gjithë vendit. Kjo bën të domosdoshme garantimin e operimit të tij dhe efikasitetin e plotë të tij.

Në sistemin tonë të transmetimit janë instaluar dhe po instalohen OPGW (Optical Ground Wire – Përcjelles tokëzimi optik) në linjat e tensionit të lartë të të gjitha niveleve të tensionit 110 kV – 220 kV – 400 kV që i përkasin OST.

Duke u nisur nga nevojat për kapacitete më të mëdha transmetimi në linjat ndërlidhëse të OST, bëhet e nevojshme rritja e kapaciteteve të transmetimit të OPGW (përcjelles tokëzimi optik) të OST, për të garantuar funksionimin normal të sistemeve të monitorimit të nënstacioneve të OST, për të evituar dhe paraprirë defektet e mundshme duke mbajtur në këto mënyra në efikasitet dhe sigurinë të plotë të rrjetit të OST. Gjithashtu duke qenë se OST është licensuar nga autoritetet përkatëse për ofrimin e shërbimeve të leasline apo ofrimin e kapaciteteve të ndryshme pike me pike ose nga një pike në shumë pika edhe duke qenë se OST zotëron një rrjet me fibra optike dhe mbi këto rrjet ka ndërtuar një rrjet tjetër të bazuar mbi teknologjinë DWDM që ofron kapacitete të larta nga 10G deri në 100G në një gjatësi valore (wavelength) dhe kërkon të zgjerohet me shumë këto rrjet duke u afruar me prirjet e klientëve tanë.

Objektivi kryesor i projektit është zgjerimi dhe rritja e kapaciteteve të transmetimit të sistemit DWDM që OST zotëron me qëllim krijimin e një rrjeti bashkëkohor i cili mundëson kapacitet dhe shpejtësi më të larta mbi fibrat optike të vendosura në linjat e transmetimit 400 kV, 220 kV dhe 110 kV të rrjetit të OST për ndërlidhjen e nënstacioneve të sistemit energjistik dhe ofrimin e këtyre kapaciteteve për paletë të treta ose për institucionet e tjera qeveritare që do të ndihmonë ata në një komunikim të shpejtë dhe me kapacitete të larta.

Qëllimi i punës përfshin planifikimin, furnizimin, instalimin, integrimin me sistemet dhe rrjetin ekzistues, vënien në punë, komisionimin dhe testimin e të gjithë komponentëve që do të instalohen si dhe linjat e transmetimit të sinjaleve si dhe të të gjithë sistemit në teresi. Duhet të bëhet inxhinjeria e të gjithë sistemit, të zbatohet dhe të vëhet në punë në përputhje me të gjithë standartet përkatëse të sistemeve energjitike, të rrjeteve të komunikimit, të ENTSO-E dhe të praktikave dhe eksperiencave me të mira të sistemeve energjitike dhe të komunikimit evropiane.

Projekti duhet të konsiderohet në teresi si zgjerim i rrjetit ekzistues dhe rritje kapacitetesh dhe të Kontraktori duhet të bëjë:

- Krijimin e sistemit duke u bazuar në inxhinjerinë dhe në site-survey (vezhgimin në terren) të bërë prej tij.
- Inxhinjerinë teknike të detajuar të sistemit
- Furnizimin e pajisjeve hardware dhe softwareve të nevojshëm

- Zbatimin e projektit, instalimin dhe konfigurimin e të gjithë pajisjeve dhe elementeve të sistemit,
- Venien në punë dhe testimin e sistemit.
- Dorezimin e dokumentacionit As Built perfundimtar.
- Testimin e Servisit të ofruar mbi sistemin e implementuar, mbi funksionimin, konfigurimin dhe mirembajtjen e sistemit.
- Sistemi dhe pajisjet duhet të jenë në përputhje dhe të bazuara në versionet e fundit të standarteve ndërkombetare dhe rekomandimeve (ITU-T, ETSI, IEF, IEEE etc.) (Rekomandimet Europiane).
- Garancinë sipas termave të kontratës.

Sistemi duhet të vihet në punë në zbatim të gjithë standarteve përkatëse ndërkombetare, të ENTSO-E dhe të praktikave dhe eksperiencave me të mira të sistemeve të komunikimit dhe atyre energjitike evropiane.

Kontraktori/Ofertuesi duhet të kryejë vëzhgim në terren (Site – Survey) si dhe teste në mënyrë që të realizojë inxhinjerinë e saktë dhe një sistem funksional.

Për realizimin, kontraktori duhet të japë prioritetin maksimal elementeve të mëposhtem:

- Krijimin e sistemit me arkitekturë që të garantojë rritjen e kapaciteteve në sistemin DWDM nepermjet linjave elektrike me OPGW
- Krijimin e sistemit me arkitekturë që të garantojë shpejtësi me të mëdha në rrjetin egzistues DWDM.
- Projektimin e sistemit duke pasur parasysh mundësinë e zgjerimit të tij në të ardhmen.
- Inxhinjeria e rrjetit të komunikimit bazuar mbi infrastrukturën ekzistuese të telekomunikacionit të OST
- Krijimin e rrjetit me arkitekturë që të garantojë zgjerimin e kapaciteteve transmetuese egzistuese si dhe të garantojë integrimin 100% me rrjetin egzistues me koston më të ulët.
- Menaxhim dhe aksesimi i sistemit DWDM nga distanca “Remote Connection”.
- Përshtatjen dhe ndërlidhjen e sistemit zgjerues që do ofrohet me rrjetin egzistues të OST dhe ndërfaqen me elementet e ndryshëm të rrjetit të linjave të OST.
- Pajisjet që do ofrohen për zgjerimin e rrjetit egzistues DWDM duhet të jenë në përputhshmeri të plote të funksioneve të sistemeve ekzistuese të OST sic janë:
 - SCADA-EMS
 - Telembrojtje
 - Telefonia (Voice)
 - Telematje
 - SHAM&SHAG
 - Rrjet i brendshëm LAN

- Sistemi AMR – Automatic Meter Reading (Sistemi i Matjes)

Zgjerimi I rrjetit qe do te ofrohet duhet te jete Kompatible me rrjetin egsistues DWDM qe OST ka te instaluar ne rrjetin e vet. Gjithashtu Zgjerimi I ofruar duhet te jete ne nivel bordi (karte) e cila duhet te jete compatible me paisjet egsistuese.

Kontraktori duhet te paraqese te gjithe dokumentacion teknik ne OST per miratim.

Kontraktori duhet te parashikoje te gjitha pajisjet dhe aksesoret e nevojshem venien ne pune te sistemit (si ne nenstacione ashtu dhe ne OST) edhe pse nuk jane te permendura ne menyre specifike ne dokumentacionin e projektit. Pra, duhet te perfshihen te gjithë elementet sipas projektit teknik te zbatimit dhe vezhgimit ne terren (Site – Survey) ne menyre qe sistemi i implementuar te jete funksional sipas kerkesave.

2. Arkitektura e sistemit

2.1. Te pergjithshme

Pershkrimi i meposhte synon te paraqese kriteret baze, kerkesat si dhe konturet mbi te cilat duhet te dizenjohet zgjerimi i rrjetit dhe sistemit egzistues.

Sistemi duhet te siguroje rritjen e kapaciteteve te transmetimit te DWDM, marrjen dhe transmetimin e te dhenave per te mbeshtetur aktivitetet dhe kontrollin, me nje nivel maksimal te besueshmerise.

Kontraktori duhet te kryeje nje vezhgim ne cdo site “site survey” dhe testime, ne menyre qe te njohe dhe te evidentojë pajisjet dhe menyren e ndertimit te rrjetit.

Aktualisht rrjeti i transmetimit i OST ka rreth 19 site fizike te bazuara ne teknologjin DWDM dhe rreth 2000 km fiber optike te lidhur ne to per te cilat duhet te vleresohet integrimi dhe zgjerimi i kapacitetit transmetues.

Kontraktori do te kete pergjegjësi te plote për Site-Survey, Planifikimin, Inxhinjerine dhe Vizatimet, Prodhimin, Furnizimin, Instalimin, Testimin, Komisionimin e sistemeve dhe pajisjeve, Integrimin me rrjetin ekzistues dhe Trajnim për rrjetin dhe pajisjet e tij. Furnizuesi do të ketë pergjegjësi te plotë, gjithashtu, për nderfaqesimin dhe integrimin mes rrjetit të ri qe do zgjerohet si dhe rrjetit ekzistues dhe sistemeve te OST.

Rrjeti i ri (sistemet dhe pajisjet) duhet të përfshijë të gjithë pajisjet hardware dhe software e nevojshme për të përmbushur qëllimin e punës për këtë project, kërkesat teknike dhe specifikimet. Ofertuesi duhet të propozojë zgjidhjen më të mirë bazuar në kerkesat dhe specifikimet si dhe infrastruktures egzistuese dhe duhet të jetë në përputhje të plotë me standartet dhe rekomandimet e fundit ndërkombëtare (ITU-T, ETSI, IEF, IEEE etc.) (rekomandimet evropiane).

Projekti i sistemit duhet te marre parasysh keto pika:

- Sistemi duhet te bazohet ne infrastrukturen ekzistuese DWDM te OST.
- Ai duhet te nderlidhet me sistemet ekzistuese DWDM te OST.
- Implementimin e teknologjive te avancuara te komunikimit DWDM (Dense wavelength division multiplexing) me kapacitet 10G ose 100G per nje gjatesi vale (Wavelength)
- Deshtimi i nje komponenti te vetem ose mungesa e nje lidhje nuk duhet te cenoje funksionimin e rrjetit ne teresi ose te asaj pjese te rrjetit.
- Rrjeti duhet te garantoje transmetim me kapacitete te larte dhe transmetimin e te dhenave.
- Sistemi dhe pajisjet duhet te jene te besueshem, modular dhe me mundesi zgjerimi te kapaciteteve per te ardhmen.
- Funksionimin ne menyre redundate te linjave te nderlidhese dhe kapaciteteve te transmetimit kur eshte e mundur sipas topologji se fibres optike.
- Projektimin e rrjetit dhe te sistemit duke pasur parasysh mundesine e zgjerimit te tij ne te ardhmen.
- Menaxhim dhe aksesimi nga distance nepermejt sistemit te menaxhimit.

Sistemi duhet te marrë parasysh kërkesat e mëposhtme:

- Duhet te ofrohet teknologji koherente dhe jo koherente me gjatesi vale qe supporton kapacitete nga 10G, 100G deri dhe me shum per nje gjatesi vale.
- Duhet të behet monitorimi “on line” i OSNR per Sherbimet e ofruara.
- Funkzioni OTN duhet të sigurohet në Sitet e kerkuara.
- Ndërfaqja OTN dhe ndër-lidhjet te bazuar ne OTN duhet të sigurohet (Grooming) në listen e nenstacioneve te kerkuara.
- Kapaciteti i sistemit WDM egzistues eshte 40 gjatesi vale dhe me mundësi që të rritet në 80 gjatesi vale per kete arsye the zgjerimi I rrjetit duhet te jete ne te njejten linje.
- Site Tirana -1 Do te perdoret si Site kryesor ne zgjerimin e rrjetit dhe Borde me nderfaqe aksesimi 10 x 10G dhe 2 x 10G ose 8/16 x multi rate dhet te instalohen ne kete site. Subrack-et kryesore dhe kartat kryesore duhet të jenë gati për topologjine perfundimtare te rrjetit për çdo nenstacion.
- Trafiku dhe nderfaqet e bordit duhet të llogariten bazuar në tabelën më poshtë.
- Tipi i fibrave qe do te perdoren ne te gjitha hallkat jane te tipit ITU-T G.652-D dhe ITU-T G.655.
- Modulet e ushqimit, te nderlidhjes (cross-connections) dhe ato te kontrollit duhet te jene redudante.
- Duhet të realizohet integrimi me rrjetin SDH ekzistues atje ku do kerkohet.
- Duhet te perfshihen te gjitha modulet SFP sipas servisit te kerkuar, patch cordat, licencat për aktivizimin e te gjithë portave si dhe aksesoret e nevojshem.

- Duhet të furnizohet dhe parashikohet çdo pajisje dhe aksesor i nevojshëm për realizimin e projektit edhe pse mund të mos jete i përmendur specifikisht në kërkesat e specifikimeve.
- Modulet e teknologjisë WDM - Wavelength Division Multiplexing dhe modulet e shërbimeve (aksesit) duhet të ofrohen të ndara në pajisjen OTN atje ku ajo përdoret.
- Kur të jete e nevojshme duhet të krijohen mundësi bypass-esh optike, të gjitha nën-stacionet me shërbime shtim / lenie (add & drop) duhet të projektohen me teknologjinë “reconfigurable optical add-drop multiplexer”.
- Transparenca skaj me skaj të linjave.

Tabela e Siteve të cilat duhet të integrohen në rrjet:

Nr.	Site name
1	Pristina (Site i ri)
2	Nst. 400 kV Tirana 2(Zgjerim)
3	Koplik (site I ri)
4	Bajram Curri (Site I ri)
5	Vau Dejes (Zgjerim me 100G Wavelength)
6	Gjirokastra (Zgjerim me 100G Wavelength)
7	NMS (Network Managemnt Sistem) I bazuar në teknologjinë cloud.

Kontraktori duhet të parashikojë të gjitha pajisjet dhe aksesoret e nevojshëm për sistemin dhe për të ofruar shërbimin e kërkuar (si në nën-stacione ashtu dhe në OST) edhe pse nuk janë të përmendura në mënyrë specifike në dokumentacionin e projektit.

Për të përmbushur kërkesat dhe për të fituar të gjitha avantazhet që ofron një rrjet komunikimi, është thelbësorë për të siguruar një arkitekturë redundante bazuar në dy rrugë komunikimi, ku është e mundur.

Kontraktori duhet të bëjë inxhinjerinë e sistemit dhe ta paraqesë në OST për miratim.

2.2. Nyja kryesore OTN

Nyja kryesore OTN ose burimi kryesor i trafikut është vendosur në nën-stacionin 400 kV Tirana 2 duke qenë se është nën-stacioni kryesor i rrjetit energjetik dhe në distancë më të afërt me OST. Nyja kryesore përbëhet nga pajisje transmetuese dhe komutuese në mënyrë që të realizohet rrugëzimi i të gjithë informacionit dhe

kapaciteteve transmetuese ne te gjitha drejtimet e linjave dhe stacioneve termianle. Kjo Nyje sigurom multipleksimi, funksionin per grooming dhe switching, nderfaqja OTN (optical transport network) dhe nderlidhja e bazuar ne OTN. Duke Qene se OST po shikon mundesin e ofrimit te Sherbimeve lease line dhe per kete kerkoet te jete sa me afer klienteve te vet, ne kete faz kerkoet qe site kryesor per zgjerimin e rrjetit te jete Tirana 1.

2.3. Stacioni terminal

Ne nenstacionet e percaktuara si Stacione terminale duhet te instalohen pajisje terminale te cilat te realizojne nderlidhjen me nenstacionet e rrjetit me kapacitet te larta transmetuese te OPGW si dhe te ofrojne kapacitete te larta sherbimesh duke filluar nga 100Mbit/s deri ne 100Gbit/s kapacitet.

Stacionet terminale duhet te sigurojne redudance te komunikimit si dhe kapacitet te larte 10/100G ne varesi te traktit dhe linjes ne sistem.

Ne cdo nenstacion duhet te realizohen:

- Site-Survey
- Prodhimin, ofrimin transportin dhe instalimin e pajisjeve dhe sistemit përfshirë Sistemit të Menaxhimit, shtrirjet dhe lidhjet e nevojshme te kabllave.
- Sigurimi i pajisjeve testuese dhe të mirëmbajtjes, per testimet ne vend.
- Lidhja e pajisjeve ne rrjet dhe ne menyre funksionale me burimet e energjisë, në ODF (Kuatrot optike te shperndarjes), duke përfshirë kabllot, konektoret, patch cordat optike dhe ODF-te e Sistemit përfshirë shuaresit që mund të jenë të nevojshme për t'u lidhur me ndërfaqet.
- Furnizimi dhe sigurimi i licensave të nevojshme për te realizuar komunikimin me rrjetin egzistues te menaxhimit NMS (network management system).
- Conectimin fizik ndermjet teknologjive te reja te ofruara dhe atyre ekzistuese (DWDM, NG SDH dhe rrjetet IP / MPLS) nese kerkoet.
- Integrimi i sinjaleve dhe sistemeve ekzistuese parashikuar ne kapitullin 2.9 Integrimi i sistemit.

2.4. Stacion amplifikimi

Ne rrjetin egzistues jane te parashikuar dhe disa stacione amplifikimi te cilat realizojne amplifikimin e sinjaleve dhe kapaciteteve transmetuese. Ne keto nenstacione jane instaluar amplifikator te pershtatshme per teknologjine e aplikuar. Stacionet e amplifikimit jane percaktuar ne baze te topologjise se zgjedhur nga Kontraktori/Ofertuesi ne fazen e pare dhe te dyte te projektit dhe jane aprovuar nga OST.

2.5. NMS - Sistemi i menaxhimit te rrjetit

Rrjeti egzistues I OST menaxhohet nga sistem menaxhimi qendror NMS (Network Management System). Sistemi NMS është instaluar në Godinen Kryesore të OST. Ai përbehet nga platforma hardware si dhe platforma software. NMS realizon menaxhimin në kohë reale “on line” të rrjetit WDM, të gjithë pajisjeve, konfigurimin, detektimin e defekteve etj. Ky sistem Menaxhimi mbulon të gjitha pajisjet e transmetimit DWDM si dhe ka mundësi të monitorojë gjitha pajisjet datacom –IP, security (Firewall) dhe Fix access që mund të instalohen në OST në të ardhmen. Sistemi NMS është i unifikuar për Pajisjet e transmetimit (WDM,SDH,PDH,MW) dhe të IP (router, switch, firewall). NMS është i dizenuar që të suportoje dhe zgjerimet që do të bëhen në rrjetin me element të rinj (NE-element) dhe me shërbime të reja siç mund të jetë shërbimi i aksesit (FTTX apo xDSL) në 10 Vitet e ardhshme. Në këtë projekt parashikohet që Sistemi Egzistues NMS I përberë nga server I dedikuar të zëvendësohet me një sistem të ri I bazuar në teknologjinë cloud i cili do të jetë 100% I përshtatshëm dhe do të ketë të njëjtat funksione si sistemi I mëparshëm.

2.6. Mundësia e zgjerimit dhe përditesimit

Në realizimin e zgjerimit të sistemit, Kontraktori duhet të përdorë teknologjinë me të përparuar në dispozicion në aspektin e dizajnit dhe të projektimit dhe duhet të ofrojë fleksibilitet maksimal për të mundësuar në të ardhmen zgjerimin dhe përmirësimin e sistemit në fjalë, duke pasur parasysh dinamikën dhe zhvillimin e parashikuar në vitet e ardhshme për sistemin energjetik në Shqipëri si dhe teknologjinë. Pas venies në punë të sistemit të ri, shtesat dhe përditesimet e nevojshme për të përmbushur kërkesat e reja duhet të bëhen të mundura përmes ndryshimeve ose upgradeve vetëm të sistemit software. Kërkesa është për shtimin e moduleve hardware mbi sistemin aktual WDM.

2.7. Testet e pranimit

Procedura e testimit duhet të dorëzohet nga Kontraktori në OST si minimum 1 muaj para përfundimit të punimeve dhe fillimit të testeve. Kjo procedurë do të vijë për aprovim nga OST. Në rast se procedura nuk është e plotë, OST ka të drejtë të bëjë komentet dhe ndryshimet e nevojshme dhe Kontraktori duhet të riformulojë procedurën në mënyrë që të përputhet me kërkesat dhe komentet e OST. Procedura duhet të jetë e aprovuar nga OST.

Testimet do të zhvillohen nga kontraktori në praninë e specialistëve të OST. Kontraktori duhet të njoftojë OST-në minimalisht 2 javë përpara zhvillimit të testeve..

Testet e pranimit do të kryhen në përputhje me specifikimet teknike, duke përfshirë:

- Për praninë të inxhinjerëve të sistemit nga testimet e kualifikimit, prova dhe teste të funksionimit të teknologjisë, etj.

- Për testimin e pranimit duhet të zhvillohen testime të pajisjeve terminale në sited ku do shtohen pajisjet si dhe menaxhimi i sistemit dhe teknologjise WDM të ofruar në baz të shërbimit të kërkuar. Testet duhet të përfshijn pjesën harduerike dhe softwarike të sistemit sa bashku me menaxhimin.
- Për testimin e instalimit, në çdo nënstacion terminal, testim i çdo pjesë të (duke përfshirë Hardware dhe software) pajisje WDM. (SAT – Site acceptance test)
- Për integrimin me rrjetin ekzistues të sistemit të ri që do shtohet si dhe pajisjeve të reja do të zhvillohen testime që vërtetojnë integrimin dhe nderfaqësimin midis sistemeve.
- Për pranimin e përgjithshëm të sistemit. (OAT – Overall acceptance test)
- Për pranimin përfundimtar të Sistemit

2.8. Integrimi i Sistemit

Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për pajisjet që ofron, duke përfshirë integrimin e plotë me të gjitha pajisjet e Sistemit ekzistues (Terminat dhe Kushtet). Kontraktori duhet të garantojë se do të menaxhojë dhe të zgjidhë të gjitha çështjet ndërmjet pajisjeve dhe sistemeve ekzistuese dhe atyre të reja që do të instalohen në rrjet për të siguruar një Sistem të plotë që ndërvepron.

Sistemi i ri që do ofrohet duhet të ketë mundësi nderlidhjeje me sistemet ekzistuese dhe perkatesisht:

- SCADA-EMS
- Telembrojtje
- Telefonia (Voice)
- Rrjeti i brendshëm LAN
- Sistemi AMR – Automatic Meter Reading (Sistemi i Matjes)

Te gjitha sistemet e mesiperme ekzistuese duhet të jenë funksionale pas integritimit nëse kërkohet në mënyrë të njëkohshme. Integrimi i tyre duhet të bëhet pa ndërpreje të funksionimit të tyre. Në çdo stacion do të duhet të realizohet integrimi me pajisjet ekzistuese siç janë:

- Multiplekser SDH, me transmetim STM-1 dhe STM-4,
- RTU e sistemit SCADA të nënstacionit (Remote Terminal Unit) me protokoll IEC 60870-5-104.
- Rrjeti LAN ekzistues me kapacitet 1G.
- Modulet e sistemit Telembrojtje (sistemi që realizon mbrojtjen e linjave të tensionit të lartë)
- Modulet transmetuese të sistemit AMR,
- PABX të telefonisë,

Për integrimin duhet të bëhet konfigurimi i nderfaqeve të pajisjeve ekzistuese dhe atyre të reja duke pasur parasysh protokollin dhe standartet me të cilat komunikojnë pajisjet ekzistuese të cilat janë si më poshtë:

- SDH STM-1 dhe STM-4,

- IEC 60870-5-104.
- Ethernet
- ANSI/IEEE C37.94,
- Channel associated (2Mbps)

Pas integritimit do të zhvillohen testime për verifikimin e funksioneve përkatëse. Testimet duhet të realizohen duke u nderfaqësuar me sistemet ekzistuese si dhe me anë të analizatoreve të protokollit dhe të pajisjeve testuese të secilit funksion.

2.9. Dokumentacioni

Furnizuesi pas lidhjes së kontratës duhet të ofrojë dokumentet përkatëse, për të gjithë hardware dhe software e ofruar, si më poshtë:

Para implementimit:

- Dokumentacioni i pajisjeve dhe sistemit (katalog, broshura, manual etj.)
- Dokumentacioni Inxhinierik (renditjen e dokumentave, skemat, vizatime, pershkrimet, channel list etj.)
- Dokumentacionin e Databases
- Dokumentacionin e plote të funksioneve dhe të specifikimeve të pajisjeve dhe sistemit

Pas implementimit:

- Dokumentacionin AS BUILT të implementimit (skemat perfundimtare, vizatimet, specifikimet perfundimtare, channel list, dokumentacionin e lidhjeve dhe instalimit AC, DC, FO etj.)
- Dokumentacionin e Operimit dhe Mirëmbajtjes
- Test reportet pas instalimit dhe kolaudimit të çdo pajisje aktive në stacionet terminale
- Test reportin e sistemit të menaxhimit
- Test reportin final të funksionimit të gjithë rrjetit dhe sistemeve.

2.10. Garancia, Suporti dhe mirëmbajtja

Sistemi, rrjeti dhe të gjitha pajisjet do të jenë nën garanci për periudhën e specifikuar në kontratë, por jo më pak se 1 vit nga data e dorëzimit dhe e leshimit të Çertifikatës së marrjes së pajisjeve në dorëzim.

Kontraktori duhet të marrë parasysh që OST ka të drejtën për të kërkuar ndihmë nga Kontraktori, në rast se ndodh një problem, vështirësi në lokalizimin e ndonjë defekti apo ndonjë gabim ose degradim në sistemin e instaluar gjatë punës së tij.

OST ben njoftimin në rast të një problemi, vështirësie në lokalizimin e ndonjë defekti apo ndonjë gabim ose degradim në sistemin e instaluar dhe kontraktori duhet të sigurojë ekspertizë teknike, matje të

specializuara, pajisje të nevojshme në kohën e duhur për të ndrequr defektin. Në rast se do jete e nevojshme ekspertize me e larte, kontraktori duhet te garantoje support dhe mbeshtetje teknike nga prodhuesi i pajisjeve dhe sistemeve si dhe te ofroje riparimin e paisjeve te demtuara.

Këto shërbime do të ofrohen pa pagesë për OST gjatë periudhës së garancisë.

2.11. Pjesët rezerve

Furnizuesi duhet të përfshijë në oferte pjesë rezerve (Spare Parts) për zgjidhjen e propozuar. Furnizuesi do të përfshijë në ofertë pjesët e nevojshme rezervë dhe shërbimin e riparimit dhe kthimit për mbulimin e operimit sipas garancise se ofruar.

Furnizuesi duhet të furnizojë të paktën një pjesë rezerve për zëvendesimin e cdo paisje te demtuar ne sistemin e ofruar. Lista e pjesëve rezerve, dhe kalkulimet e per perdorimin e tyre te mundshem ne secilin stacion duhet ti paraqiten dhe furnizohen OST-se.

2.12. Licensat

Furnizuesi duhet të deklarojë qartë dhe përfshijë në ofertë, funksionet dhe licensat e parashikuara për pajisjet e te gjithë sistemit (hardware dhe software). Te gjitha licensat per pajisjet, modulet dhe funksionet nuk duhet te jene te kufizuara ne kohe. Sistemi duhet te lejoje perdorimin nga disa perdorues njekohesisht per menaxhimin dhe mirembajtjen e tij.

Furnizuesi do të informojë OST në lidhje me Përditësimet e Software dhe Patchet të cilat janë në lidhje me sistemet e ofruara.

2.13. Zgjerim i kapacitetit dhe i sistemit fillestar

Sistemi I kerkuar dhe cdo pajisje e tij duhet te jete e dizenuar dhe parashikuar per nje zgjerim dhe rritje te kapaciteteve dhe moduleve te sistemit ne te ardhmen.

Prodhimi, instalimi dhe testimi i çdo pajisje të dhënë duhet te realizohet ne menyre për të përmirësuar më tej kapacitetin e Sistemit deri në kapacitetin e tij maksimal.

Furnizuesi duhet të përshkruajë menyren për përmirësimin dhe zgjerimin e pajisjeve të ofruara per kapacitet të lartë te gjatesise se vales nga 10G deri ne 100G apo 400G nese eshte e nevojshme.

3. Përshkrimi i zgjidhjes teknike

Furnizuesi duhet të tregojë në mënyrë të qartë zgjidhjen teknike ku do të referohet oferta. Zgjidhja e propozuar duhet të jetë një platformë uniforme e cila pershtatet me rrjetin egzistues i cili do të menaxhohet nga i njëjti sistem uniform i menaxhimit që menaxhon rrjetin egzistues të WDM.

3.1. Kërkesat për sistemin e rritjes së kapaciteteve të OPGW

Pajisjet DWDM të ofruara duhet të sigurojnë që matjet e fuqisë optike në dBm me një saktësi prej 5% për karte linje të OTN (marrja, transmetim), për një grup sinjalesh lineare (marrje, transmetim).

Pajisjet DWDM duhet të suportojnë rregullimin automatik të fuqisë dalese në varësi të numrit të kanaleve që janë në punë në sistem. Pajisjet DWDM duhet të punojnë në kontroll automatik të fuqisë dalese në një, duke përfshirë ndryshimet në numrin e kanaleve optike.

Zgjidhja e propozuar duhet të ketë mundësi suportaje:

- 40 kanale x 10G ose 100G për kanal dhe mundësi zgjerimi deri në 80 kanale.
- Modulimin kryesor në një bartës të vetëm 100 G, PDM-QPSK.
- Komutimin universal ODUk / VC / MPLS-TP për zhvillimin e ardhshëm, sipas draftit MS-OTN përcaktuar nga ITU-T.
- Sistemi i propozuar nga ana 100G DWDM duhet të suportojë 40 kanale të komutueshme dhe të parametrizueshme në të gjithë bandën C të përcaktuar në Rekomandimin G.694.1 të ITU-T. -

3.2. Kërkesat e arkitektures së sistemit

Furnizuesi do të sigurojë diagramen funksionale të nivelit të lartë për llojet e pajisjeve në lidhje me OTM (Optical multiplexer terminal), FOADM (Fixed optical add/drop multiplexer), ROADM (Reconfigurable optical add/ drop multiplexer) dhe perforcuesve optike në linjë (OLA – Optical line amplifier) me referencë të veçantë për:

- Brezi i gjatësisë së vave dhe kapaciteti i sistemit DWDM siç përcaktohet në rekomandimin ITU-T G.694.1,
- Pajisjet e ofruara duhet të suportojnë aplikime të teknologjisë DWDM dhe CWDM në të njëjtin nen-rack (kase). Brezi i gjatësisë së vave dhe kapaciteti i sistemit DWDM siç përcaktohet në rekomandimin ITU-T G.694.2 9.
- Sistemi dhe pajisjet e ofruara duhet të jenë të zgjerueshme (upgradeable) nga 40 kanale në 80 kanale hibride 10G/100G λ ,
- Modulariteti i arkitektures së sistemit 40ch/80ch për aplikacione dhe rrjet fleksibel p2p, ring dhe mesh.
- Rrjeti DWDM duhet të dimensionohet për të përdorur gjatësi vave hibride 10G/100G.

- Hardwari i sistemit të ofruar në shtesë të kërkuara duhet të bazohet në strukturën OTN me njërin anë klient (Tributary) dhe në anën e linjes DWDM me shtresën elektrike dhe të suportoje aftësinë grooming/switch:
- ❖ Ana klient (Tributary): mund të ketë akses në standartet GE, STM-1, STM-4, STM-16, 10G LAN, WAN 10G, STM-256, 100GE, OTU1, OTU2, OTU3, OTU4, FICON, ESCON, FC1G / 4G / 8G / 10G në të njëjtën pajisje në të cilën janë instaluar bordet.
- ❖ Ana e linjes DWDM: mund të sigurojë 10G /100G për kanal.
- ❖ Shtresa elektrike (grooming / switching): zgjidhja e ofruar duhet të mbështesë ODUK (k=0,1,2,3,4,flex) të centralizuar, nderlidhje (cross-connection) VC-x (x = 12,3,4) dhe MPLS-TP bazuar në switching me paketa.
- Në pajisjet e propozuara OTN, çdo slot universal duhet të suportoje jo më pak se kapaciteti 100Gbit / s për slot.
- Krijimi i switching të ODUK duhet të jetë në gjendje për të bërë gjitha nderlidhjet (cross-connections) të drejtuara nga EMS/NMS, ndërfaqja e kontrollit dhe mekanizmat e tjere.
- Krijimi i switching të ODUK duhet të jetë rreptësisht jo-blokues për të gjitha nderlidhjet (cross-connections) e implementuara.
- Duhet të suportohet dhe garatohet një sistem plotësisht redundant (mbrojtje 1+1), matricë switching e centralizuar dhe jo-blokuese me asnjë pikë të vetme dështimi.
- Kalimi manual mes dy kopjeve redundante të matricës nuk duhet të ndikojë në trafik.
- Pajisja e propozuar duhet të suportoje 6 nivele të TCM për monitorimin e cilësisë së transmetimit dhe lokalizimin e defekteve.
- Furnizuesi duhet të tregojë detajet e matricës të OTN duke paraqitur dhe treguar kapacitetin total të komutimit (switching) në dispozicion për secilën kartë ndërfaqe tributare ose të linjes.
- Pajisja e propozuar duhet të suportoje komutim (switching) në shtresën elektrike L2 bazuar në VLAN dhe MAC Address. Ajo duhet të suportoje menaxhim baze të ethernetit duke përfshirë menaxhim të shërbimeve EPL/EVPL dhe EPLAN/EVPLAN.
- Karta e shtresës L2 të pajisjeve të propozuar duhet të suportoje të paktën 32K MAC.
- Furnizuesi duhet të detajojë QOS (Quality Of Service) skaj me skaj për komutimin (switching) në shtresën L2.
- Sistemi i propozuar duhet të suportoje LAG (Link Aggregation Group) e cila mund të mbrojtë portat që kanë LACP (Link Aggregation Control Protocol) të aplikuar.
- Sistemi i propozuar duhet të suportoje VLAN multicast. Furnizuesi duhet të detajojë atë.

- Sistemi i propozuar duhet të suportoje ETHOAM 802.1ag / 802.3ah), Ethernet O & A & M. Furnizuesi duhet të detaje atë.
- Sistemi i propozuar duhet të suportoje shërbimin e agregimit Ethernet nga FE / GE për GE, FE / GE ne 10GE.
- Ofertuesi duhet të japë detaje rreth transmetimit 100G hibrid i implementuar në kartat e linjave të OTN 100G si më poshtë:
 - ❖ Toleranca e Polarization Mode Dispersion (PMD) për kartat e linjes OTN 100G.
 - ❖ Metodologjia e kompensimit PMD (channel-wise ose e perbere për të gjithë sinjalin DWDM).
 - ❖ Metodologjia e Chromatic Dispersion Compensation (CDM) (Static CDM, Tuneable Dispersion Compensation (TDC), DC për sinjal DWDM të përbërë ose për kanal)
 - ❖ Format i modulimit (Keying) në krahasim me formatet e tjera të modulimit 100G dhe një përfundim nga të mirat e formatit të zgjedhur nga prodhuesi i zgjedhur në krahasim me formate të tjera të mundshme.
 - ❖ Arritje maksimale transmetimi prej 100G pa 3R- regeneration (EOE).

3.3. Modelimi i Sistemit dhe Projektimi i Rrjetit

Furnizuesi duhet të përshkruajë në detaje llojet e amplifikatoreve (erbium-doped EDFA) të suportuara dhe metodat me të cilat arrihet kompensimi i dispersionit, si dhe duke theksuar kërkesat e OSNR për kartat e linjave të OTN 100G (OSNR me e ulet e pranuar për secilin tip të kartave të linjes për pragje të ndryshme të performances EOL bit gabimit (BER) që garantohej).

Më tej përshkrimi duhet të përmbajë nëse janë përdorur në zgjidhjen DWDM amplifikatore të fazave të tjera EDFA me akses në Mid-stage. Në rastin e amplifikatoreve me akses në Mid-stage, futja, rregullimi, dhe ndikimi i moduleve duhet të përshkruhet.

Furnizuesi duhet të përshkruajë në detaje teknologjinë, të percaktuar për multiplexing / de-multiplexing të kanaleve DWDM. Parametrat që duhet të përshkruhet janë:

- Teknologjia multipleksimit (p.sh. Arrayed Waveguide Grating (AWG) apo të tjera)
- Aftësia për të ofruar kanale të ngjyrave individuale pa ndërfaqe linje OTN kur kërkohej.
- Humbjet për kanal të njesive multiplexing /de-multiplexing.

Furnizuesi duhet të përshkruajë në detaje buxhetin e fuqisë optike të platformës së ofruar DWDM për lloje të ndryshme fibrash të tilla si G.652 dhe G. 655 për aplikimet single dhe multi-span, si dhe suporti apo funksionimi për konfigurim të përzier të fibrave G.652 dhe G.655.

Përveç kësaj furnizuesi do të deklarojë performancën e garantuar të BOL dhe EOL BER për lambda 100G për konfigurimet e suportuara.

Kërkesa teknike për propozim teknik shqyrton teknologjive aktuale dhe të ardhme NG DWDM dhe çdo ndërveprim që ata mund të kenë me shtresën e transportit IP/MPLS. Për shkak të trafikut në rritje kërkesa kryesore është për të analizuar efikasitetin e bandwidth-it që mund të arrihet me OTN të bazuar në WDM duke marrë parasysh kërkesat e mëposhtme:

- Transporti me kapacitet të lartë
- Multipleksim dhe aftësitë grooming
- Mundësitë optike të bypass
- OTN bazuar në aftësitë OAM (Operations Administration and Maintenance - ethernet protocol) (si SDH).
- Transparenca skaj me skaj.

Pajisjet e propozuara duhet:

- të jetë plotësisht në përputhje me ITU-T G.709 dhe ITU-T G.798.
- të zbatojnë multipleksim sinkron në nivele ODUk / OPUk.
- të suportojnë standartet GMPLS (RFC 3945) ose Ason (ITU-T G.8080).
- të suportojnë Ason / GMPLS bazuar në shtresën optike dhe shtresën elektrike.
- të suportojnë funksionin të centralizuar të komutimit të paketave të kalimit në MS-OTN (multi-service optical transport network).
- Pajisjet në sitet shtesë të kërkuara (Koplik, B Curri, Prishtin) duhet të suportojnë funksionin Grooming në hardware dhe të ketë mundësi të aktivizohet me license në pjesën software.

3.4. Menaxhimi i fuqisë dhe Monitorimi i Fibrave

Sistemi I ofruar duhet të ketë mundësi të suportojë (kur ti kërkohej) ekuilibrin automatik të fuqisë për mbajtjen OSNR dhe njëtrajtshmerise se fuqisë optike të çdo kanali, si dhe për kontrollin automatik të nivelit duke marrë në konsideratë variacionet në kohë të shuarjes për shkak të vjetërimit të ngjitjeve (splicing) dhe / ose shtimin / pakësimin e kanaleve të shumta të hyrjes .

Furnizuesi do të deklarojë suportimin e reduktimit automatik të fuqisë e saj të uljes automatike për shkak të keputjes së fibra apo dështimit të pajisjeve, si dhe të mbylljes automatike të lazerit për linjat e ndërfaqes optike ose amplifikatorët e sistemit OTN 100G të ofruar.

OSC (Optical Supervision channel) duhet të jetë i ndarë nga amplifikatori, për të shmangur ndonjë problem në mbikëqyrjen të amplifikatoreve jonormale (problematik).

Gjate heqjes së lambdave nga sistemi, trafiku i mbetur nuk duhet të ndikohet në asnjë rast.

Furnizuesi duhet të sigurojë një zgjidhje me funksion të monitorimit të OSNR 100G në një gjatësi vale, dhe saktësia e monitorimit të OSNR duhet të jetë brenda +/- 1dB.

Duhet të suportohen shtresa OCH (Optical channel with full functionality) (ODUk / OTUk) me referencë të veçantë për të postuar zbulimin e gabimit FEC (Forward Error Correction) dhe Tandem connection monitoring (TCM).

Pajisja e propozuar duhet të suportojë si ESC (Electric Supervisory Channel) dhe OSC (Optical Supervisory Channel).

3.5. Kanali optik i supervizimit

Sistemi I ofruar duhet të ketë mundësi të suportojë (kur ti kërkohe) dhe duhet të përshkruajë krijimin dhe funksionimin e kanalit optik të supervizimit (OSC- optical supervisory channel) i cili operojnë në gjatësi vale 1510 nm për qëllime të marrjen e informacionit të rrjetit të menaxhimit dhe përdorimit të kanaleve të komunikimit të përgjithshëm të standartit G.709 për kartën e linjes të OTN 100G të ofruar. Duhet të shprehet nëse kanali OSC përfshihet në balancimin e fuqisë hyrëse të Njesisë së Multipleksimit Optik.

3.6. Faktori “Latency” dhe “Jitter”

Furnizuesi duhet të tregojë faktorin “Latency” që paraqitet nga llojet e ndryshme të kartës së linjes OTN 100G. Faktori “Jitter” dhe specifikimet duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve G.825 dhe IEEE 802,3 2005 dhe IEEE 802.3ae për ndërfaqet SDH dhe Ethernet.

3.7. Enkapsulimi i sinjalit të klientit

Furnizuesi duhet të deklarojë përputhshmërinë e tij për perputhjen e GFP (Generic Framing Procedure) sipas standartit ITU-T G.7041 dhe përshkruajë suportin e saj për skemat e mëposhtme të enkapsulimit Ethernet referuar kartës tributare të OTN 100G sipas aplikimit. Furnizuesi duhet të qartësojë nëse Ethernet për OTN është sipas standartit G.709 dhe në qoftë se të dy opsionet e hartimit GFP-F dhe GFP-T janë në dispozicion, duke theksuar përfitimet e skemës encapsulation të suportuar. Për më tepër furnizuesi duhet të përshkruajë në qoftë se ndonjë skemë tjetër enkapsulimi Ethernet suportohet nga zgjidhja teknike e dhënë. Furnizuesi duhet të përshkruajë zgjidhjen e tij për hartimin 10GE LAN PHY të ODU- 2 (Optical channel Data Unit-2).

